www.qendravatra.org.al

STOP.. DROGËS!

NDRYSHO JETËN TËNDE

QENDRA PSIKO-SOCIALE "VATRA"

ÇFARË JANË DROGAT?

Teknikisht, drogat janë lëndë kimike, të cilat ndikojnë në funksionimin normal të trupit dhe / ose të trurit.

Jo të gjitha drogat janë të paligjshme. Për shembull, kafeina (e cila gjendet në kafe ose në pijen "Coca-Cola"), nikotina (e cila gjendet në cigare) dhe alkooli teknikisht janë droga të ligjshme edhe pse zakonisht nuk quhen të tilla.

Barnat, si ato që shiten me recetë të lëshuar nga mjeku ashtu edhe ato që shiten pa recetë nëpër farmaci, janë droga të ligjshme të cilat na ndihmojnë të kurohemi ndaj sëmundjeve, megjithëse edhe me to mund të abuzohet.

EKZISTOJNË 4 GRUPE TË NJERËZVE, QË:

- kurrë nuk e pranojnë drogën;
- e marrin vetëm në ndonjë festë;
- rregullisht e marrin (narkomanët);
- dita-ditës e shtojnë dozën.

TIPAT KRYESORË TË DROGAVE

1. Kanabis
2. Kokaina
3. Ekstazia
4. Heroina
5. Hauciogjenet: LSD
6. Metamfitamina

CILAT DROGA JANË MË SHQETËSUESE?

Drogat më shqetësuese për komunitetin janë ato psikoaktive, sepse veprojnë mbi trurin dhe ndryshojnë mënyrën se si mendon, sillet ose ndjehet individi. Tri llojet kryesore të drogave psikoaktive, janë: depresantët, stimulantët dhe haluciogjenet.



1.DEPRESANTËT

- alkooli
- kanabisi
- benzodiazepinat (valiumi, serepaksi, mogadoni, normisoni)
- barbituratet
- GHB (Gama-Hidroksibutrat)
- opiumi (heroina, morfina, kodeina, metadoni, petidina)
- disa tretës dhe thithës

Drogat depresuese nuk shkaktojnë gjithnjë depresion te përdoruesi. Në të kundërt, ato ndikojnë te përqëndrimi e koordinimi dhe ngadalësojnë aftësinë për t'ju përgjigjur situatave të papritura. Depresantët kur merren në sasi të vogla mund të shkaktojnë çlodhje. Në sasi të mëdha mund të shkaktojnë humbjen e vetëdijes, të vjella, madje edhe vdekjen.

2. STIMULANTËT

NDAHEN NË DY KATEGORI:

1. Stimulantët e lehtë

- kafeina
- nikotina
- efedrina (përdoret në mjekimet për bronkitin, alergjinë e pranverës dhe astmën)

2. Stimulantët e fortë

- amfitaminat
- kokaina
- ekstazia
- tabletat dobësuese
- khat

Drogat stimuluese shpejtojnë veprimtarinë e trurit. Si rrjedhim personi që merr stimulantin ndjehet më i gjallë, i vëmendshëm dhe i sigurt te vetja. Ato rritin rrahjet e zemrës, temperaturën e trupit dhe tensionin e gjakut. Stimulantët pakësojnë oreksin, zmadhojnë pupilat e syrit, sjellin pagjumësi, si dhe e bëjnë përdoruesin që të flasë pa pushim apo të jetë pak nervoz.

Marrja e sasive të mëdha të stimulantëve shkakton ankth, panik, kriza, dhembje koke, dhembje në stomak, agresivitet dhe paranojë.

3. HALUCINOGJENET

- datura (lloj bime)
- ketamina
- LSD (acid dietilamid lisergi)
- kërpudhat magjike
- meskalina (kaktus pejoti)
- PCP
- kanabis
- ekstazi

Drogat halucinogjene shndërrojnë mënyrën se si personi sheh rreth vetes. Personat që marrin këto droga mund të shohin apo të dëgjojnë gjëra që nuk ekzistojnë, ose mund të shohin gjëra të tjetërsuara.

Efekte të tjera të halucinogjeneve janë zmadhimi i pupilave të syrit, ikja e oreksit, rritja e lëvizjeve, folje dhe të qeshura të tepruara, eufori emocionale e psikologjike, shtrëngim të nofullave, djersitje, panik, paranojë, humbje të kontaktit me realitetin, sjellje të çuditshme dhe të paarsyeshme, dhembje në stomak dhe përzierje.



PËRSE I PËRDORIN NJERËZIT DROGAT?

Nuk ka asnjë arsye të caktuar.

Shumica e njerëzve i përdorin drogat për t`u ndjerë më mirë ose thjesht për të qenë ndryshe. Ata i përdorin drogat, sepse besojnë në dobishmërinë e tyre. Por, në të vërtetë ato nuk kanë asnjëlloj dobie, por vetën rreziqe.
Njerëzit i përdorin drogat për t'u çlodhur, për t'u argëtuar, për t'u bërë pjesë e shoqërisë, për shkak të kureshtjes, ose për t'i shpëtuar dhembjes fizike dhe psikologjike.
Të rinjtë i përdorin drogat për të njëjtat arsye që i përdorin edhe të rriturit.

SI NDIKON DROGA TE NJË PERSON?

Efektet e një droge të caktuar varen nga disa faktorë:

1. LLOJI I DROGËS QË ËSHTË MARRË

Të gjitha drogat ndikojnë në mënyrë të ndryshme te persona të ndryshëm.

2. SASIA DHE SHPESHTËSIA E PËRDORIMIT TË DROGËS

Në përgjithësi, sa më e madhe të jetë sasia e drogës që merret aq më i madh është edhe efekti i saj. Personi mund të vuajë nga mbidoza nëse sasia e marrë është e madhe.

3. MËNYRA NËPËRMJET TË CILËS MERRET DROGA

Drogat që merren me anë të injeksionit ose thithjes janë më të shpejta dhe efekti i tyre është më intensiv. Thithja me hundë vjen e dyta nga shpejtësia e veprimit dhe pas saj vijnë drogat që merren me gojë ose përtypje dhe këto veprojnë pak më ngadalë.

4. KARAKTERISTIKAT FIZIKE

Efekti i drogës ndikohet edhe nga gjatësia, pesha dhe gjinia e përdoruesit. Intensiteti dhe jetëveprimi i drogës varen edhe nga sasia e dhjamit në trup, niveli metabolik dhe faza e ciklit menstrual të femrës.

5. HUMORI DHE MJEDISI I PËRDORUESIT

Në efektin e drogës një rëndësi të veçantë ka edhe mënyra se si ndjehet përdoruesi dhe se në cilin mjedis merret droga. Personi ka më shumë mundësi që ta shijojë drogën në një mjedis shoqëror të qetë se sa një atmosferë të keqe.

VARËSIA NGA DROGA?

Varësia nga droga mund të jetë fizike ose psikologjike.

Një person që varet nga droga fizikisht, zakonisht zhvillon një lloj tolerance ndaj saj. Kjo do të thotë që për të marrë efektin e duhur, përdoruesi duhet që të marrë shumë e më shumë drogë. Një person që varet nga droga mendon se nuk mund të arrijë kënaqësi emocionale pa përdorur drogë.

ÇFARË PROBLEMESH SHKAKTON PËRDORIMI I DROGËS?

1. PROBLEME ME SHKOLLËN OSE PUNËN

Një person që përdor drogë mund të mos mësojë apo punojë ashtu siç duhet, sepse ndjehet i lodhur dhe nervoz. Kjo mund të sjellë një ambient të pasigurt në punë, sidomos nëse përdoruesi drejton automjete apo makineri të rënda. Përdoruesit e drogës mund të marrin më shumë ditë pushim për shkak të sëmundjeve dhe nuk janë në gjendje që të punojnë mirë.

2. AKSIDENTET

Përdorimi i drogës ndikon te personi duke pakësuar aftësinë për t'u përgjigjur shumë shpejt në situata të papritura. Ajo ndikon në aftësinë e të menduarit qartë dhe në mbajtjen e vëmendjes. Droga mund të shkaktojë shikim të dobët, ngërçe, të përziera dhe simptoma të tjera fizike. Këto efekte rrisin mundësinë e aksidenteve rrugore, mbytjeve dhe kalimin e rrugës në mënyrë të pasigurt.

3. PROBLEME ME SHKELJEN E LIGJIT

Përdorimi i drogës sjell probleme ligjore, si për shembull, sulme dhe krime të kryera me qëllimin e marrjes së të hollave për të vazhduar përdorimin e drogës. Këto veprime përbëjnë vepër penale dhe janë të dënueshme nga ligji (gjithashtu edhe nga legjislacioni shqiptar).

4. PROBLEME FINANCIARE

Kostoja e përdorimit të vazhdueshëm të drogës do të thotë që përdoruesi mund të mos ketë të holla të mjaftueshme për të blerë ushqime, veshje ose për të paguar faturat.

5. PROBLEME SHËNDETËSORE

Duhani, alkooli dhe drogat e paligjshme mund të shkatojnë probleme të rënda shëndetësore nëse përdoren për një kohë të gjatë. Ngrënia e pakët dhe pagjumësia, duke qenë pasoja të drogës, ngrenë mundësitë e shfaqjes të një sërë ndërlikimesh shëndetësore. Personat që marrin drogë me injeksione janë në rrezik të marrjes së Hepatitit B, Hepatitit C dhe SIDA-s.

6. PROBLEME SEKSUALE

Disa droga e bëjnë një person të ndjehet shumë i eksituar nga ana seksuale. Megjithatë e njëjta drogë mund të shkaktojë probleme seksuale si impotenca.

7. PROBLEME NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Fëmijët marrin shembull prej prindërve, gjyshërve, vëllezërve apo motrave më të mëdhenj dhe mësojnë shumë prej tyre në sjellje dhe mendime. Nëse një anëtar i familjes përdor drogë apo alkool për t'u çlodhur, ose për të harruar një problem, edhe fëmijët do t'i përdorin këto metoda.

FJALET ME TE ZAKONSHME PER DROGEN

Narkotikë

- Substanca që kanë fuqi që të sjellin gjumë te një person ose ta bëjnë atë të turbullt, të lehtësojnë dhembjet, të zbehin ndjesitë ose të shkaktojnë humbjen e vetëdijes.

Mbidoza

- Ndodh kur merret një sasi e tepruar droge dhe trupi nuk është në gjendje që ta konsumojë.

Drogë psikoaktive

- Drogë që ndikon në sistemin nervor qendror. Ka ndikim mbi trurin dhe si rrjedhim mbi mënyrën se si personi mendon, ndjehet dhe sillet.

Tolerancë

- Aftësia e trupit për të konsumuar drogën.

Kriza e mungesës

- Nëse një person që merr drogë e ndërpret atë ose pakëson sasinë, atëherë tek ai ose ajo mund të shfaqen simptoma fizike të ndryshme sepse trupi ka filluar të mësohet që të funksionojë me drogë.

Shumë të rinj mashtrohen ta provojnë drogën nga shokët, qoftë nga kureshtja, qoftë nga frika.

THONI JO!!!

Adresa: Lagjia: Isa Boletini, Rr: Nermin Vlora Falaski
Vlorë, Albania
Tel & Fax: +35533 224078 / 228048
e-mail: qvatra@icc-al.org
www.qendravatra.org.al

design: Klevis Janko
shtypi: shtypshkronja "PEGI", Tiranë

Publikimi i këtij materiali informativ është mbështetur nga fondacioni Kvinna Till Kvinna me fonde të LINDEX në kuadrin e projektit "Fushatë ndërgjegjësimi për sensibilizimin e grave, vajzave dhe rinisë shkollore, për rrezikun që paraqet trafikimi i qenieve njerëzore dhe fenomenet e tjera negative që rrjedhin prej tij".

KVINNA TILL KVINNA